




Sheshi "Bill Klinton" Nr.13 Prishtinë, Kosovë Bulevar "Bill Klinton" Br.13 Prishtina, Kosovo  
 Tel: 038/226-070, 225-006, Fax: 038/226-159; Email: info@ iber-lepenc.org

## Raporti Vjetor 2022 për NPH "Ibër Lepenc" Sh.A



### Vendimi nr: I

Bordi i Drejtorëve në mbledhjen e rregullt të mbajtur më dt.15.03.2023 pas shqyrtimit të Raportit Vjetor për vitin 2022 ,mbi zhvillimet e aktiviteteve afariste në kompani,mori vendim për miratimin e këtij raporti dhe kërkoj që i njëjti raport të përcillet në NJPMNP.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshef Ekzekutiv	Kryesues i Bordit të Drejtorëve
Nënshkrimi	z. Faruk Mujka	z. Bajram Mustafa
Data: 15.03.2023		





NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

---

**Për: NJËSINË PËR POLITIKA DHE MONITORIM TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE**

**Nga: BORDI I DREJTORËVE TË N.H."IBER-LEPENC", SH.A. PRISHTINË**

**Lënda: RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022**

**Data: 15.03.2023**

---

## **RAPORTI VJETOR I PUNËS - 2022**

**N.H. "IBER-LEPENC"**

**Prishtinë**

---

## Përmbajtja:

<b>Për: NJËSINË PËR POLITIKA DHE MONITORIM TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE</b> .....	1
<b>1. FJALËT HYRËSE</b> .....	4
1.1 Fjala e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve NH “Ibër-Lepenc”:	4
1.2 Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të NH “Ibër-Lepenc”:	5
<b>2. RAPORT I PUNËS SË KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE</b> .....	6
2.1 Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes .....	6
2.2 Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2022 .....	7
2.3 Të Hyrat .....	7
2.3.1 Të Hyrat nga Energjia Elektrike .....	8
2.3.2 Të Hyrat nga Uji .....	9
2.3.3 Të Hyrat nga Ujitja .....	9
2.3.4 Të Hyrat tjera.....	10
2.4 Shpenzimet.....	11
2.5 Ngjarje të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes.....	12
Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm .....	12
Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden.....	13
<b>3 Raporti i Punës së Kryeshefit Ekzekutiv</b> .....	17
3.1 Aktivitetet Kryesore të Ndërmarrjes .....	17
3.2 Pasqyra e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës .....	17
3.2.1 Të hyrat.....	19
3.2.2 Të hyrat nga energjia elektrike.....	21
3.2.3 Të hyrat nga uji.....	23
3.2.4 Të hyrat nga ujitja.....	25
3.2.5 Të hyrat tjera .....	27
3.3 Shpenzimet.....	27
Të hyrat dhe shpenzimet Janar-Dhjetor 2022 krahasuar me planin dhe me vitin e kaluar.....	28
3.4 Të Hyrat.....	29
3.5 SHPENZIMET KAPITALE DHE PROJEKTET .....	29
3.5.1 Aktivitetet e prokurimit per vitin 2022 .....	29
3.6 DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM.....	34

3.7 DEPARTAMENTI I ZYRËS LIGJORE .....	37
3.8 DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERZORE .....	37
4 Perspektiva për vitin e ardhshëm.....	38
4.1 Rreziqet .....	39
4.2 Përfundime.....	39
5 NJESIA IMPLEMENTUESE e WSCP .....	40
HISTORIKU .....	40
Të dhënat kryesore të Projektit.....	40





NDËRMARRJA HIDROEKONOMIKE "IBËR - LEPENC" SH.A.  
HYDRO - ECONOMIC ENTERPRISE "IBËR - LEPENC" J.S.C.  
VODOPRIVREDNO PREDUZEĆE "IBËR - LEPENC" D.D.

---

**Për: NJËSINË PËR POLITIKA DHE MONITORIM TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE**

**Nga: BORDI I DREJTORËVE TË N.H."IBER-LEPENC", SH.A. PRISHTINË**

**Lënda: RAPORTI VJETOR I PUNËS PËR VITIN 2022**

**Data: 15.03.2023**

---

## **RAPORTI VJETOR I PUNËS - 2022**

**N.H. "IBER-LEPENC"**

Prishtinë

---

## Përmbajtja:

<b>Për: NJËSINË PËR POLITIKA DHE MONITORIM TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE</b> .....	1
<b>1. FJALËT HYRËSE</b> .....	4
1.1 Fjala e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve NH "Ibër-Lepenc":.....	4
1.2 Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të NH "Ibër-Lepenc": .....	5
<b>2. RAPORT I PUNËS SË KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE</b> .....	6
2.1 Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes .....	6
2.2 Aktivitetet kryesore të ndërmarrja gjatë vitit 2022 .....	7
2.3 Të Hyrat .....	7
2.3.1 Të Hyrat nga Energjia Elektrike .....	8
2.3.2 Të Hyrat nga Uji .....	9
2.3.3 Të Hyrat nga Ujitja .....	9
2.3.4 Të Hyrat tjera.....	10
2.4 Shpenzimet.....	11
2.5 Ngjarje të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes.....	12
Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm .....	12
Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden.....	13
<b>3 Raporti i Punës së Kryeshefit Ekzekutiv</b> .....	17
3.1 Aktivitetet Kryesore të Ndërmarrjes .....	17
3.2 Pasqyra e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës .....	17
3.2.1 Të hyrat.....	19
3.2.2 Të hyrat nga energjia elektrike.....	21
3.2.3 Të hyrat nga uji.....	23
3.2.4 Të hyrat nga ujitja.....	25
3.2.5 Të hyrat tjera .....	27
3.3 Shpenzimet.....	27
Të hyrat dhe shpenzimet Janar-Dhjetor 2022 krahasuar me planin dhe me vitin e kaluar .....	28
<b>3.4 Të Hyrat</b> .....	29
3.5 SHPENZIMET KAPITALE DHE PROJEKTET .....	29
3.5.1 Aktivitetet e prokurimit per vitin 2022 .....	29
<b>3.6 DEPARTAMENTI PËR PLANIFIKIM DHE ZHVILLIM</b> .....	34

3.7 DEPARTAMENTI I ZYRËS LIGJORE .....	37
3.8 DEPARTAMENTI I BURIMEVE NJERZORE .....	37
4 Perspektiva për vitin e ardhshëm.....	38
4.1 Rreziqet .....	39
4.2 Përfundime .....	39
5 NJESIA IMPLEMENTUESE e WSCP .....	40
HISTORIKU .....	40
Të dhënat kryesore të Projektit.....	40

# 1. FJALËT HYRËSE

## 1.1 Fjala e Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve NH "Ibër-Lepenc":

- Raporti i Kryesuesit të Bordit të Drejtorëve të NH "Iber Lepenc" sh.a. është hartuar në emër të anëtarëve të bordit të drejtorëve dhe paraqet pikëpamjet gjithëpërfshirëse dhe sfidave me të cilat ballafaqohet ndërmarrja e që kanë të bëjnë me zhvillimin dhe përmirësimin e shërbimeve me interes publik.

Në këtë raport janë paraqitur rezultatet operative, rezultatet financiare duke u fokusuar në aspektet që ndikojnë drejtëpërdrejt në rritjen e kualitetit të shërbimeve dhe në përgjithësi efikasitetit të ndërmarrjes nga ana operacionale dhe financiare.

Gjatë vitit që lamë pas, BD në vazhdimësi ka analizuar çështje me rëndësi në interes të performancës së ndërmarrjes si dhe i është kushtuar kujdes të veçant problemeve dhe sfidave të cilat ne si ndërmarrje kemi në fokus për arritjen e objektivave dhe realizimit të Planit të Biznesit.

Qëllimi kryesor i BD mbetet rritja e vlerës së aseteve dhe shfrytëzimit sa më të madh të kapaciteteve dhe veprimtarisë duke u angazhuar për të siguruar rritjen e të hyrave gjatë viteve në vazhdim. Mirëmbajtja dhe operimi i infrastrukturës ekzistuese, modernizimi i sistemit, rehabilitimi dhe zgjerimi i kanalit kryesor mbeten qëllim dhe synim i ndërmarrjes dhe menaxhmentit.

BD në mënyrë sistematike në baza mujore, tre mujore dhe vjetore ka analizuar, monitoruar dhe raportuar për rezultatet operative, duke përfshirë të hyrat e gjeneruara në kuadër të veprimtarisë.

Bordi i Drejtorëve mbetet i përkushtuar që të vazhdojë të realizojë prioritetet e ndërmarrjes, kërkesat e klientëve duke ofruar në vazhdimësi shërbime sa më të mira dhe kualitative por njëkohësisht duke krijuar një ambient sa më të favorshëm me klientet tonë si dhe me fermeret individual.

Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve

N.H. "Iber-Lepenc" Sh.A Prishtinë

Bajram Mustafa

---



## 1.2 Fjala e Kryeshefit Ekzekutiv të NH "Ibër-Lepenc":

Prioritetet tona për të ardhmen mbeten të fokusuar në ofrimin sa më kualitativ të shërbimeve, mirëmbajtjen dhe operimin e infarstrukturës ekzistuese, rehabilitimi dhe zgjerimi i kapaciteteve, si dhe rritjen e të hyrave financiare.

Në Planin strategjik zgjerimi i ndërmarrjes në aspektin e aseteve si dhe në aspektin e veprimtarisë mbeten si qëllim. Gjithashtu prioritet në zhvillimin e afarizmit të ndërmarrjes do të jenë:

- Ofrimi i shërbimeve kualitative dhe plotësimi në vazhdimësi i kërkesave për klientët tonë,
- Mirëmbajtja e aseteve kryesore ekzistuese, rritja e investimeve kapitale në mënyrë të vazhdueshme dhe afatgjate.
- Rehabilitimi dhe modernizimi i Hidrocentralit në tërësi, rehabilitimi i kanalit kryesor, automatizimi i tërësishëm i sistemit të komandimit dhe monitorimit të objekteve të ndërmarrjes, digjitalizimi i sistemit të N.H."Ibër-Lepenc" nëpërmjet projektit SCADA si dhe bashkepunimi i vazhdueshëm me Bankën Botërore në projektet e saja në të mirë të zhvillimit të N.H."Ibër-Lepenc", mbeten disa nga detyrat tona gjatë viteve në vazhdim.

Përkundër sfidave, viti 2022 konsiderojmë se ishte një vit i suksesshëm afarist, duke ju falenderuar angazhimit të gjithë të punësuarve, stafit menaxherial, zyrtarëve të lartë, qeverisjes profesionale kooperative nga ana e Bordit të drejtorëve, si dhe mbështetjes institucionale nga aksionari (Qeveria e Republikës së Kosovës).

Edhe këtë vit jemi përballur me shumë probleme dhe vështirësi duke përfshirë këtu edhe problemet me ndërtim në afërsi dhe mbi sistemin e ujitjes, të cilat kanë ndikuar që ujitja të mos realizohet në mundësitë dhe kapacitet që ndërmarrja posedon.

Vështirësi më të theksuara kanë qenë: sasi të jo të mjaftueshme të ujit në kanal kryesorë në fillim të sezonit të ujitjes, kycjet ilegale dhe të përnjëhershme të fermerëve në sistemin e ujitjes, mungesa të mëdha të shiut sidomos gjatë kohës së vegjetacionit, dëmtimi i gypave dhe fazonerisë nga keqbërës të ndryshëm. Ndërrimi i destinacionit të tokave bujqësore me infrastrukturë të ujitjes, zbrasja e ujërave të zeza në kanalet e ujitjes, ndërtimet mbi sistemin e ujitjes si dhe toka bujqësore e ngelur djerrinë (të pa punuara) nën sistemet e ujitjes.

Sa i përket anës financiare, kemi realizuar performancë pozitive e cila ka ndikuar që shërbimet ndaj klientëve të kryhen në kohë, më cilësi dhe sasi të nevojshme për të plotësuar kërkesat e tyre dhe pritshmëritë e ndërmarrjes sonë.

Kryeshefi Ekzekutiv  
Faruk Mujka  
N.P.H. "Iber-Lepenc" Sh.A Prishtinë

## 2. RAPORT I PUNËS SË KRYESUESIT TË BORDIT TË DREJTORËVE


### 2.1 Aktivitetet dhe performanca e ndërmarrjes

Në këtë raport vjetor do të i theksojmë disa momente më karakteristike të cilat kanë pasur ndikim kryesor gjatë vitit në rrjedhat e afarizmit të ndërmarrjes:

- Realizimi sasi-or-gjenerimi i energjisë elektrike është realizuar për 11% më shumë se sasitë e planifikuara të energjisë me rishikimin e planit të biznesit, pra janë gjeneruar 77,950 MWh kurse të planifikuara kanë qenë 71,236.00 MWh. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjenerimi i energjisë elektrike ishte më i ultë për 31,484 MWh.

- Prodhimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2022 ishte me i lartë sesa prodhimi i planifikuar për 9% dhe më i ulët sesa ai i vitit të kaluar për 29%. Distribrimi i ujit ishte më i lartë sesa ai i planifikuar për 0.3 % dhe më i ulët sesa distribuimi i vitit paraprak për 0.1%. Ujitja ishte më e lartë sesa ajo e vitit paraprak për 66% dhe më e lartë sesa ajo e planifikuar për 23%. Sa ju përket të hyrave, të hyrat e përgjithshme ishin më të larta sesa ato të vitit paraprak për 51% dhe më të larta sesa plani për 66%. Shpenzimet gjatë vitit 2022 ishin më të ulta në krahasim vitin paraprak (6%) dhe më të larta se shpenzimet e planifikuara për 0.5%.

Diagrami i gjenerimit të energjisë elektrike për vitin 2022






## 2.2 Aktivitetet kryesore të ndërmarra gjatë vitit 2022

Duke u bazuar në njoftimet paraprake me shkrim të dërguara tek kontraktori dhe pas mos kryerjeve të punëve sipas kontratës dhe pas angazhimit të ekspertit ligjor dhe ekspertizës së dorëzuar ku konstatohet se Kontraktuesi ka dështuar të përmbush obligimet që dalin nga marrëdhënia kontraktuale dhe si e tillë është përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së detyrimeve dhe realizimit të projektit, me datë: 4.07.2022 në mbledhjen e mbajtur të rregullt të Bordit të Drejtorëve, autorizohet U.D Kryeshefi z. Januz Kabashi që të ndërprejë kontratën me nr. WSCP-W-ICB-1 për projektin: Rehabilitimi i kanalit kryesor të NH "Ibër-Lepenc" sh.a. me kontraktuesin "GENER 2" shpk.


## 2.3 Të Hyrat

Periudha Janar-Dhjetor 2022 shënoi të hyra totale prej 9,627,018 €. Kjo shumë ishte më e lartë sesa shuma e planifikuar për gjithsej 3,822,466 € apo 66%. Realizimi i të hyrave për këtë periudhë ishte për 51% më e lartë sesa realizimi i të hyrave për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.




### 2.3.1 Të Hyrat nga Energjia Elektrike

Të hyrat nga energjia elektrike arrijtën shifrën prej 7,060,927€ duke përbërë kështu 73.34 % të hyrave totale.



Bazuar në të dhënat e mbledhura, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 u prodhuan 77,950 MWh energji elektrike, sasi kjo që është më e lartë për 6,687 MWh se prodhimi i planifikuar. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjenerimi i energjisë elektrike ishte më i ultë për 31,484 MWh





### 2.3.2 Të Hyrat nga Uji

Të hyrat nga uji ishin 2,363,494 € duke përbërë kështu rreth 24.55% të të hyrave totale. Kjo shumë ishte 0.4% më e lartë sesa shuma e planifikuar dhe 13% më e lartë sesa ajo e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Të hyrat nga uji janë paraqitur grafikisht në figurën më poshtë. Nga aspekti i gadishmërisë së ofrimit të shërbimeve publike gjegjësisht ofrimit të ujit të papërpunuar për nevoja të industrisë dhe të ujësjellësve, nga ndërmarrja janë plotësuar të gjitha kërkesat ndaj blerësve.

Sipas kërkesave të shfrytëzuesve të ujit nga sistemi i IL-it gjatë vitit 2022 janë distribuar këto sasi të ujit, gjithësej **62,180,066 m<sup>3</sup>** apo të përshkruara nëpërmjet formës tabelare si më poshtë:


#### Furnizimi me ujë për vitin 2022

KRU Mitrovice	20,871,364
KRU Mitrovice ( Vushtrri)	7,206,789
KUR Prishtina (Shkabaj)	16,785,008
KUR Prishtina (Drenas)	3,489,734
NewCo Ferronikel CoL.L.C	1,581,591
KOSOVA B	10,859,400
KOSOVA A	1,386,180
<b>TOTALI</b>	<b>62,180,066</b>

### 2.3.3 Te Hyrat nga Ujitja


Nj.A."Ujitja" gjatë vitit 2022 ka mbajtur disa takime me faktorët relevant për zhvillimin e bujqësisë siç janë: Ministria e Bujqësisë, Drejtoritë e Bujqësisë nëpër komunat: Mitrovicë, Vushtrri, Obiliq, Prishtinë dhe Drenas me shoqatat e fermerëve si dhe me fermerët individual.

***Të hyrat nga ujitja kapën një shifër prej 176,389 € duke përbërë kështu rreth 1.83% të të hyrave totale. Kjo shumë ishte më e lartë se ajo e planifikuar për 23% dhe më e lartë se ajo e vitit të kaluar për 66%.***



#### 2.3.4 Të Hyrat tjera

Të hyrat nga burime tjera ishin 26,206.97 €. Të hyrat e tjera përbëjnë rreth 0.27 % të të hyrave totale.




## 2.4 Shpenzimet

Sipas të dhënave të paraqitura në tabelë, shpenzimet e realizuara gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 kapën një shifër prej 4,430,032 €. Kjo shumë ishte për 0.5% më e lartë sesa shuma e planifikuar dhe 6% më e ulët sesa ajo e realizuar gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2021

	Janar-Dhjetor 2021 Realizimi	Janar-Dhjetor2022 PLANI	Janar-Dhjetor 2022 Realizimi
Të hyrat	6,372,091	5,804,552	9,627,018
Shpenzimet	4,700,848	4,406,547	4,430,032

**Tabela e të dhënave financiare për periudhën Janar – Dhjetor 2022**





## 2.5 Ngjarje të cilat ndikojnë në të ardhmen e ndërmarrjes

Fatkeqësitë elementare natyrore (reshjet e mëdha, rrëshqitjet e tokës, vërshimet etj.) mund të ndikojnë në dëmtimin e aseteve të ndërmarrjes.

- Thatësitë ekstreme mund të rrezikojnë realizimin e gjenerimit të planifikuar të energjisë elektrike
- Mosarkëtimi i kërkesave nga klientët me kohë dhe borgjet e këqija
- Zvogëlimi i sipërfaqeve bujqësore në hidrosistem për shkak të ndërrimit të destinacionit nga toka bujqësore në toka urbane
- Shpenzimet e larta në sektorin e ujitjes;
- Promovimi i vazhdueshëm i ujitjes në zona të veçanta me qëllim të rritjes së sipërfaqeve të ujitura
- Të negociojë çmim më të favorshëm të energjisë elektrike,
- Implementimi i rekomandimeve të BD dhe implementimi i rekomandimeve të Auditorit të Jashtëm,
- Reduktimi i shpenzimeve fikse.

### Një pasqyrë e të priturve për vitin e ardhshëm

Buxheti i ndërmarrjes për vitin 2023 është përpiluar në bazë të:

- Madhësive fizike të prodhimit dhe shërbimeve;
- Nevojave materiale për të siguruar procesin e punës;
- Vlerës së aseteve.

Shpenzimet janë shprehje e kërkesave të departamenteve, respektivisht të njësive punuese duke pasur parasysh çdo herë racionalizimin e tyre në një shkallë të mundur. Buxheti i ndërmarrjes në vitin 2023, do të jetë buxhet unik, për të cilin participojnë njësitë dhe departamentet dhe do të jetë në funksion të ndërmarrjes si tërësi. Mirëmbajtja investive si dhe pagat e punëtorëve janë pjesa më e madhe e buxhetit.

Buxheti për paga është kalkuluar bazuar në numrin e pritur të punëtorëve të cilët do të marrin paga gjatë vitit 2023.

Varësisht nga performanca dhe nga rezultati afarist i ndërmarrjes dhe në pajtim me politikat e aprovuara nga Bordi i Drejtorëve, me vendim të veçantë të Bordit nëse i njëjti konstaton se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj, do të shpërndahet edhe një shumë për stimulim të efektshmerisë për të punësuarit në ndërmarrje dhe për Drejtorët e Bordit.



Vlera e kësaj shume për stimulim të efektshmerisë, në rast të tejkalimit të parametrave të planit afarist, do jetë së paku në lartësinë e një page mujore të secilit punëtor. Kjo do të aplikohet pas aprovimit të raportit financiar periodik apo vjetor nga Kryeshefi Ekzekutiv.

Në vitin 2023, pritet të realizohen të hyrat në shumën totale prej **5,588,570€** ndërsa shpenzimet operative planifikohen të jenë **4,873,708€**. Investimet kapitale të planifikuara për vitin 2023 janë në shumë prej **2,234,972 €**.

### **Informacione lidhur me kapitalin dhe dividenden**

Kredite e rëndësishme të nënshkruera apo të paguara gjatë vitit 2022

Ndermarrja nuk ka nënshkruar ndonjë kredi të re gjatë vitit 2022, perkunder kesaj ka vazhduar me implementimin dhe zbatimin e kredise dhe marreveshjes ne mes Bankes Boterore dhe Qeverise se Republikes se Kosoves per pojektin: Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit(WSCP) me nr. Te kredis 5902-XK.

### **Të dhënat kryesore të Projektit**

Numri i Projektit	P133829	Data e Fillimit	
Shuma e Huazuar	Total - 22,000,000.00 € IL - 15,000,000.00 €	Data e Efektivitetit	30 Prill 2017
Shuma e Disbursuar	5,020,273.54€/20.36%	Data e Përfundimit të Projektit Pas Ri-strukturimit	31 Prill 2022 <b>31 Tetor 2023</b>

Projekti “Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit (WSCP)”, është një Projekt 5-vjeçar i financuar nga një kredi e siguruar nga IDA për Qeverinë e Republikës së Kosovës. Ku kjo e fundit ka kërkuar nga Banka Botërore që të mbështesë këtë projekt i cili ka për qëllim rehabilitimin e kanalit ekzistues, kanal ky që ngërthen në vete një sistem shumë funksional të furnizimit me ujë, siq janë: furnizimi me ujë për prodhimin e energjisë elektrike, miniera, qëllime industriale, ujitje të tokave bujqësore dhe furnizimin me ujë të papërpunuar për ujësjellësin e Prishtinës dhe Mitrovicës.

Agjencia Zbatuese për Projektin është Ndërmarrja Hidroekonimike Ibër Lepenc (ILC), ndërsa Njësia Zbatuese e projektit është themeluar për të siguruar WSCPP me mbështetje teknike dhe

është përgjegjëse për koordinimin, menaxhimin e projektit, planifikimin vjetor, monitorimin, raportimin dhe shpërndarjen e rezultateve të Projektit. ka stafin e nevojshëm dhe kompaninë konsulente të kontraktuar në mënyrë t'i mbulon të gjitha çështjet administrative dhe teknike për zbatimin e Projektit.

Duke u bazuar në njoftimet paraprake me shkrim të dërguara tek kontraktori dhe pas mos kryerjeve të punëve sipas kontratës dhe pas angazhimit të ekspertit ligjor dhe ekspertizës së dorëzuar ku konstatohet se Kontraktuesi ka dështuar të përmbush obligimet që dalin nga marrëdhënia kontraktuale dhe si e tillë është përgjegjëse për dështimin e përmbushjes së detyrimeve dhe realizimit të projektit, me datë: 4.07.2022 në mbledhjen e mbajtur të rregullt të Bordit të Drejtorëve, autorizohet U.D Kryeshefi z. Januz Kabashi që të ndërprejë kontratën me nr. WSCP-W-ICB-1 për projektin: Rehabilitimi I kanalit kryesor të NH "Ibër-Lepenc" sh.a. me kontraktuesin "GENER 2" shpk.

## 2.6 Investimet e rëndësishme të bëra gjatë vitit 2022

### INVESTIMET NËN PROJEKTIN "Siguria e Ujit dhe Mbrojtja e Kanalit"

Lëvizja e llogarisë së investimit të projektit për periudhat e raportuara është si më poshtë:

	Kosto	Zhvlerësimi I Akumuluar	Vlera Neto
<b>Me 01 Janar 2020</b>	<b>199,989</b>	<b>-4,933</b>	<b>195,056</b>
Shtesat	2,533,597	-	2,533,597
Shitjet (heqjet)	-	-2,369	-2,369
<b>Me 31 dhjetor 2020</b>	<b>2,733,586</b>	<b>-7,302</b>	<b>2,726,284</b>
Shtesat	791,518		791,518
Shitjet (heqjet)		-3,158	-3,158
<b>Me 31 dhjetor 2021</b>	<b>3,525,104</b>	<b>-10,460</b>	<b>3,514,644</b>
Shtesat	937,201		937,201
Shitjet (heqjet)		-953,381	-953,381
<b>Me 31 dhjetor 2022</b>	<b>4,462,305</b>	<b>-963,841</b>	<b>3,498,464</b>



**Emrat e Drejtorëve të Bordit gjatë vitit duke përfshirë të gjitha kompensimet, shpenzimet dhe pagesat për shërbimet e ndërmarrjes.**

Me vendimin e Qeverisë me nr.03/73 të datës 30.04.2022 për Drejtorë të Bordit të Ndërmarrjes Publike qendrore NPH "Ibër - Lepenc" Sh.A. emëron këta kandidat

- 1. Bajram Mustafa - Kryesues**
- 2. Avdullah Nishori - Anëtar**
- 3. Violeta Hoxha - Anëtare**
- 4. Valmira Latifi - Anëtare**
- 5. Denis Dautaj - Anëtar**
- 6. Muzafer Luma - Anëtar**

Ministrja e Ekonomisë me Vendimin me nr.01/1026 të datës 05.05.2022 emëron Komisionin e Auditimit në këtë përbërje:

- 1. Z.Denis Dautaj – Kryesues i Komisionit të Auditimit**
- 2. Znj.Violeta Hoxha – Anëtare**
- 3. Znj.Valmira Latifi– Anëtare**

**Kompensimet dhe shtesat të BD për vitin 2022:**

<b>Emri dhe Mbiemëri</b>	<b>Pozita</b>	<b>Bruto</b>	<b>Kontributet</b>	<b>Tatimi</b>	<b>Neto</b>
Bajram Mustafa	Kryesues BD	5251.89	262.59	498.93	4490.37
Denis Dautaj	Kryesuesi I KA	4910.33	245.52	466.48	4198.33
Valmira Latifi	Anëtare	4606.53	230.33	437.62	3938.59
Violeta Hoxha	Anëtare	4596.53	229.83	436.67	3931.75
Muzafer Luma	Anëtar	3695.33	184.73	285.24	3225.32
Avdullah Nishori	Anëtar	3696.00	184.77	351.06	3159.50

## **Numri i takimeve të Bordit të Drejtorëve gjatë vitit 2022 si dhe numri i pjesëmarrjes së drejtorëve në takimet e Bordit**

Bordi i Ndërmarrjes NH "Ibër-Lepenc" gjatë vitit 2022 gjithsejt ka mbajtur 13 mbledhje, takimi njoftues i mbajtur me dt.10.05.2022 ku Bordi i Drejtorëve është njoftuar me menaxhmentin e ndërmarrjes dhe me gjendjen e ndërmarrjës ,shtatë(7) nga këto takime, kanë qenë mbledhje të rregullta kurse një (1) ka qenë mbledhja e përgjithshme vjetore dhe 5 mbledhje të jashtëzakonshme.

Kuorumi ka qenë përherë i mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjeve .

Gjatë këtij viti BD ka marre 11 vendime te rëndësishme ne kuadër te punëve, nder to disa si me te rëndësishme ajo e ndërprerjes se Kontrates me kontraktuesin "Gener2", shpallja e konkursit dhe përzgjedhja e Kryeshefit të ri ekzekutiv, vendimi per emërimin e Komitetit për staf dhe shpërblime dhe të tjera.

### Vendimi mbi emërimin e Kryeshefit Ekzekutiv:

- Duke u bazuar në kompetencat dhe autorizimet e Bordit të Drejtorëve që dalin nga neni 21 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-111 per emërimin dhe zgjedhjen e zyrtarëve të lartë të NP-ve, në mbledhjen e mbajtur me dt. 01.12.2022 pas nje procesi transparent dhe të rregullt rekrutues për pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv morri këtë vendim që: z. Faruk Mujka emërohet në pozitën e Kryeshefit Ekzekutiv të NH "Ibër Lepenc" sh.a, vendim i cili ka hyrë në fuqi nga data 06.12.2022 nga edhe kur ka filluar punën Kryeshefi i emëruar.

Komiteti i Auditimit është mbledhur para çdo mbledhje të Bordit të Drejtorëve, ka mbajtur tetë (8) mbledhje të rregullta, ashtu siç edhe është përcaktuar me ligj.



### **3 Raporti i Punes së Kryeshefit Ekzekutiv**

#### **3.1 Aktivitetet Kryesore të Ndërmarrjes**

Krahas punëve të rregullta në udhëheqje dhe organizim, sektori ekonomiko-financiar gjatë vitit 2022 ka kryer këto aktivitete:


- Përgatitja e Pasqyrave financiare të vitit 2022 si dhe bashkëpunimi me ekipin e auditorëve të jashtëm për auditimin e këtyre pasqyrave;
- Dorëzimi i pasqyrave financiare të vitit paraparak në ATK, KKRF dhe MZHE;
- Bashkëpunimi me Bankat afariste të Kosovës dhe mbikëqyrja e procesit të menaxhimit të parave të gatshme nëpër llogari;
- Bashkëpunimi i rregullt me zyrat rregullatore – ZRRE dhe ARRU
- Dorëzimi i raporteve të rregullta periodike tek stafi menaxhues për gjendjen dhe performancën financiare të ndërmarrjes;
- Faturimi në baza të rregullta i shërbimeve të ofruara për klientët;
- Regjistrimi i të gjitha transaksioneve në librat e kontabilitetit të ndërmarrjes;
- Bashkëpunimi me klientët dhe përkujdesja për arkëtimin e borxheve duke veçuar KUR “Mitrovica”, dhe Feronikelin. Udhëheqja dhe organizimi i procesit të regjistrimit dhe inventarizimit të mjeteve dhe burimit të mjeteve në ndërmarrje;

#### **3.2 Pasqyra e performancës operative dhe rezultatet e indikatorëve kyç të performancës**

Në këtë raport vjetor do të i theksojmë disa momente më karakteristike të cilat kanë pasur ndikim kryesor gjatë vitit në rrjedhat e afarizmit të ndërmarrjes:


Realizimi sasi-or-gjenerimi i energjisë elektrike është realizuar për 11% më shumë se sasi-të e planifikuara të energjisë me rishikimin e planit të biznesit, pra janë gjeneruar 77,950 MWh kurse të planifikuara kanë qenë 71,236.00 MWh. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjenerimi i energjisë elektrike ishte më i ultë për 31,484 Mwh.

## Diagrami i gjenerimit të energjisë elektrike për vitin 2022



Prurjet mesatare të ujit në akumulimin në Ujëman gjatë vitit 2022 kane qenë  $13,5 \text{ m}^3 / \text{s}$ , që do të thotë se kemi pasur prurje thuajse të njëjta me prurjet mesatare vjetore, ( $13,05 \text{ m}^3 / \text{s}$ ) që është marre si bazë për projektimin e sistemit dhe të kapacitetit gjenerues të HC Ujman, vlenë të theksohet se kemi pasur një trend të shpejtë të rritjes së prurjeve gjatë muajit nëntor dhjetor.

## Prurjet për vitin 2022




Niveli i ujit në akumulim me 1 janar 2022 ka qenë në kuotën  $680.40 \text{ m}$  ( $259 \text{ mil. m}^3$ , shkalla 81), ndërsa me 31 dhjetor 2022 niveli ka qenë në kuotën  $688.19 \text{ m}$  ( $328 \text{ mil. m}^3$ , shkalla 38.5).

*Prodhimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2022 ishte më i lartë sesa prodhimi i planifikuar për 9% dhe më i ulët sesa ai i vitit të kaluar për 29%. Distribuími i ujit ishte më i lartë sesa ai i planifikuar për 0.3 % dhe më i ulët sesa distribuimi i vitit paraprak për 0.1%. Ujitja ishte më e lartë sesa ajo e vitit paraprak për 66% dhe më e lartë sesa ajo e planifikuar për 23%. Sa ju përket të hyrave, të hyrat e përgjithshme ishin më të larta sesa ato të vitit paraprak për 51% dhe më të larta sesa plani për 66%. Shpenzimet gjatë vitit 2022 ishin më të ulta në krahasim vitin paraprak (6%) dhe më të larta se shpenzimet e planifikuara për 0.5%.*

### 3.2.1 Të hyrat

Periudha Janar-Dhjetor 2022 shënoi të hyra totale prej 9,627,018 €. Kjo shumë ishte më e lartë sesa shuma e planifikuar për gjithsej 3,822,466 € apo 66%. Realizimi i të hyrave për këtë periudhë ishte për 51% më e lartë sesa realizimi i të hyrave për periudhën e njëjtë të vitit të kaluar.






## Tabela e të dhënave financiare për periudhën Janar-Dhjetor 2022

N.r.	Emërtimi	Nj.mat.	Realizimi Janar-Dhjetor 2021	Plani Janar-Dhjetor 2022	Realizimi Janar-Dhjetor 2022	Indeksi plani	Indeksi 2021
0	1	2	3	4	5	6 (5:4)	7(5:3)
1	<b>PRODHIMI</b>						
1.1	Energjia elektrike	Mwh	109,434	71,263	77,950	109	71
1.2	Uji	m <sup>3</sup>	62,267,211	62,001,529	62,180,066	100	100
1.3	Ujitja	ha	963	1,300	1,604	123	167
2	<b>TË HYRAT</b>	€	<b>6,372,091</b>	<b>5,804,552</b>	<b>9,627,018</b>	<b>166</b>	<b>151</b>
2.1	Energjia elektrike	€	4,050,593.00	3,307,422	7,060,927.08	213	174
2.2	Uji	€	2,090,558.96	2,353,822	2,363,494.22	100	113
2.3	Ujitja	€	105,971.80	143,000	176,389.40	123	166
2.4	Të tjera	€	124,967.43	309	26,206.97		21

### 3.2.2 Të hyrat nga energjia elektrike

Të hyrat nga energjia elektrike kapën një shifër prej 7,060,927€ duke përbërë kështu 73.34 % të hyrave totale.



Bazuar në të dhënat e mbledhura, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2022 u prodhuan 77,950 MWh energji elektrike, sasi kjo që është më e lartë për 6,687 MWh se prodhimi i planifikuar. Në krahasim me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, gjenerimi i energjisë elektrike ishte më i ultë për 31,484 MWh





Fig 1. Gjenerimi i energjisë elektrike Janar-Dhjetor 2022 krahasuar me planin dhe vitin e kaluar

Në tabelën në vijim shihen sasitë e gjeneruara të energjisë dhe të planifikuara që nga viti 2009:

Nr.R.	Viti	Sasia e En.Elekt.në MW		c
		a	b	
		Realizuar	Planifikuar	% (a/b)
1	2009	88,667	76,000	116.67
2	2010	115,460	88,000	131.2
3	2011	75,432	75,500	99.91
4	2012	65,120	71,107	91.58
5	2013	99,387	86,683	114.66
6	2014	101,517	86,894	116.83
7	2015	101,537	84,000	120.88
8	2016	96,868	88,000	110.08
9	2017	87,513	86,000	101.76
10	2018	118,421	95,600	123.87
11	2019	83,527	87,273	95.71
12	2020	63,335	67,176	94.28
13	2021	109,435	104,436	104.79
14	2022	77,950	71,236	109.42

Niveli i ujit në akumulim me 1 janar 2022 ka qenë në kuotën 680.40 m (259 mil. m<sup>3</sup>, shkalla 81), ndërsa me 31 dhjetor 2022 niveli ka qenë në kotën 688.19 m (328 mil. m<sup>3</sup>, shkalla 38.5). Në grafikonin e më poshtëm është paraqitur sasia e ujit (mil. m<sup>3</sup>) në fillim të çdo muaji.






### 3.2.3 Të hyrat nga uji

Të hyrat nga uji ishin 2,363,494 € duke përbërë kështu rreth 24.55% të të hyrave totale. Kjo shumë ishte 0.4% më e lartë sesa shuma e planifikuar dhe 13% më e lartë sesa ajo e periudhës së njëjtë të vitit të kaluar. Të hyrat nga uji janë paraqitur grafiksht në figurën Nga aspekti i gadishmërisë së ofrimit të shërbimeve publike gjegjësisht ofrimit të ujit të papërpunuar për nevoja të industrisë dhe të ujësjellësve, nga ndërmarrja janë plotësuar të gjitha kërkesat ndaj blerësve.

Sipas kërkesave të shfrytëzuesve të ujit nga sistemi i IL-it gjatë vitit 2022 janë distribuar këto sasi të ujit, gjithësej **62,180,066 m<sup>3</sup>** apo të përshkrura nëpërmjet formës tabelare si më poshtë

Furnizimi me ujë /m<sup>3</sup> për vitin 2022


KRU Mitrovice	20,871,364
KRU Mitrovice ( Vushtrri)	7,206,789
KUR Prishtina (Shkabaj)	16,785,008
KUR Prishtina (Drenas)	3,489,734
NewCo Ferronikel CoL.L.C	1,581,591
KOSOVA B	10,859,400
KOSOVA A	1,386,180
<b>TOTALI</b>	<b>62,180,066</b>



Në tabelën e më poshtme është paraqitur sasi të e distribuara të ujit ndër vite 2016-2022

	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022
KRU Mitrovice	22,135,680.00	22,075,200.00	20,200,320.00	22,075,200.00	21,954,240.00	21,820,226.00	20,871,364.00
KRU Mitrovice ( Vushtrri)	2,104,555.00	4,964,655.00	5,687,460.00	6,291,392.00	6,145,937.00	6,711,579.00	7,206,789.00
KUR Prishtina(Shkabaj)		8,951,275.00	12,953,871.00	17,241,712.00	18,562,436.00	16,632,124.00	16,785,008.00
KUR Prishtina(Drenas)	2,055,456.00	2,049,840.00	371,520.00	3,234,717.00	3,654,041.00	3,544,462.50	3,489,734.00
NewCo Ferronikel Co.L.L.C	2,049,863.00	2,522,880.00	2,308,608.00	2,301,024.00	1,813,374.00	1,947,361.50	1,581,591.00
TC KOSOVA B	11,067,840.00	10,743,840.00	8,920,105.00	9,396,142.00	10,518,336.00	10,437,480.00	10,859,400.00
TC KOSOVA A		2,270,736.00	481,140.00	3,204,540.00	754,560.00	1,173,971.00	1,386,180.00
<b>TOTALI</b>	<b>39,413,394.00</b>	<b>53,578,426.00</b>	<b>50,923,024.00</b>	<b>63,744,727.00</b>	<b>63,402,924.00</b>	<b>62,267,204.00</b>	<b>62,182,088.00</b>


Sasi të e distribuara të ujit për shfrytëzuesit e N.H."Ibër-Lepenc për vitin 2022



### 3.2.4 Të hyrat nga ujitja

Nj.A."Ujitja" gjatë vitit 2022 ka mbajtur disa takime me faktorët relevant për zhvillimin e bujqësisë siç janë: Ministria e Bujqësisë, Drejtoritë e Bujqësisë nëpër komnat: Mitrovicë, Vushtri, Obiliq, Prishtine dhe Drenas me shoqatat e fermerëve si dhe me fermerët individual.

***Të hyrat nga ujitja kapën një shifër prej 176,389 € duke përbërë kështu rreth 1.83% të të hyrave totale. Kjo shumë ishte më e lartë se ajo e planifikuar për 23% dhe më e lartë se ajo e vitit të kaluar për 66%.***



Vlen të theksohet se përgatitjet për fillimin e sezonës së ujitjes 2022 kane filluar me kohë dhe për këtë, kemi ndërmarrë veprimet e duhura në tri drejtime:

- Kampanja**- Informimi i fermerëve për fillimin e sezonit të ujitjes.
- Kontraktimi** i sipërfaqeve për ujitje.
- Përgatitja teknike e sistemit** (rehabilitimi i të gjitha defekteve në sistem).



Më poshtë në mënyrë tabelore po paraqesim sipërfaqet e planifikuara për vitin 2022 dhe ato të ujitura nga viti 2019 deri më 2022

Njësia Punuese	Sipërfaqet projektuese ha,	Sipërfaqet rehabilituara ha,	Sipërfa. e ujitura ha,	Sipërfa. e ujitura ha,	Sipërfa. e ujitura ha,	Sipërfa. e ujitura, ha	Sipërfaq e planifikuar, ha
			2019	2020	2021	2022	2022
1	2	3	6	7	7	7	8
<b>Vushtrri</b>	7,200.00	4,500.00	590.41	531.57	533.02	734.28	700.00
<b>Shkabaj</b>	7,100.00	2,500.00	363.4	258.30	285.25	687.13	400.00
